

**AKT- THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“C & C UNLIMITED SERVICES GROUP ” shpk**

Ne Durres, sot me date 12/01/2024, ortaket themelues te shoqerise

**“C & C UNLIMITED SERVICES GROUP ” shpk**

**Znj.Valeria Campagnale** i datelindjes 15/04/1970 , lindur ne Como e banues ne Durres , shtetas Italian, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me pashaporte me numer YB3575132.

**Z. Ernesto Cherici** i datelindjes 02/11/1969, lindur ne Bolzano e banues ne Durres, shtetas Italian, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me pashaporte me numer YB3575128.

Te cilet me cilesine e “Ortakeve themelues” kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, “C & C UNLIMITED SERVICES GROUP” shpk.

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

**Shoqeria “C & C UNLIMITED SERVICES GROUP ” shpk**

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria “C & C UNLIMITED SERVICES GROUP” shpk, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasit Italian:

**Znj. Valeria Campagnale** , **Z. Ernesto Cherici** , te cilet pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.



### **Neni 3** **Selia**

Shoqeria e ka seline ne: Lagjja nr 18, Durres, Objekt me nr pasurie 16/173 dhe ZK 8511, Durres. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikës së Shqipërisë, vetem me vendim të Ortakeve themelues.

### **Neni 4** **Objekti i veprimtarise**

Konsulencë ndërkombëtare tatimore dhe fiskale. Konsulencë për lokalizimin e kompanive të huaja në Shqipëri. Web Design. Shitje online me shumice dhe pakice të artikujve industrial. Pasuri të paluajtshme. Dizajn grafik. Marrëdhëniet me botën e informacionit në emër të kompanive, institucioneve publike apo private dhe organizatat. Organizimi i eventeve muzikore. Kryerja e cdo veprimtarie të ligjshme në funksion të fushave të veprimtarise të referuara me sipër.

### **Neni 5** **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### **KREU II** **Kapitali** **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 200000 (dyqind mijë lekë), i cili ndahet ne 2 kuota, ne raport me kontributin e dhene nga ortakët ne shoqeri ku ortakët zoterojne kuota te ndare si me poshte :

Ortaku, **Znj. Valeria Campagnale** : zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke, qe perbejne 50 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Ortaku, **Z. Ernesto Cherici** : zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke, qe perbejne 50 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

### **Neni 7** **Transferimi i kapitalit**

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit



e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimarrës**

Ortakët e shoqerise jane organi vendimarrës i shoqerise. Ortakët e shoqerise jane organi vendimarrës i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortakët vendosin per çeshtje si :


- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

#### **Neni 9**



## Administrimi

Administratori i shoqërisë “C & C UNLIMITED SERVICES GROUP” sh.p.k caktohet brenda ortakerisë.

Ortaku Znj. Valeria Campagnale emërohet Administratori i shoqërisë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asambleja e ortakeve të shoqërisë.

## Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Perfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregulltë të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- d) Përgatitë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve të paraqesin këto dokumenta përpara asamblese së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e asamblese në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktiviteti i Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administratori, si së bashku edhe veças njeri tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori e perfaqësojnë shqiptarinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë, publikë dhe /ose private vendas apo të huaj, autoritetëve shtetërorë shqiptarë apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merret përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretët nuk mund ta



injononin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prove e mjaftueshme.

**Neni 11**  
**Viti Financiar**

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti i pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

**Neni 12**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Biznesit"
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper"

**Neni 13**  
**Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfar do ligji tjetër specific ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 14**  
**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlere te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare " **C & C UNLIMITED SERVICES GROUP** " sh.p.k, nenshkruset ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

**Valeria Campagnale**

**Ernesto Cherici**

